

Shtojca 10

KRITERET E VLERSIMIT

Ofertat do të vlerësohen në baze të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pike më tepër në baze të kriterëve të vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, në baze të kriterëve të mëposhtme:

Metodologjia e vlerësimit

Nr.	Kriteret	Vlera maksimale e pikëve për:	Vlerësi mi në pike	Formula e llogaritjes në pike për vlerat e ofertuesve
1	Vlera e "Fee koncesionare" (e shprehur në % të energjisë elektrike vjetore të prodhuar)	Vlerën maksimale të kriterit	20	$P_i = \frac{F_{cei}}{F_{ce\max}} \times 23$
2	Ndikimi ekologjik dhe social		22	
3	Fuqia e instaluar e përcaktuar me prurjen llogaritëse	Vlerën maksimale të kriterit	22	$P_i = \frac{F_i}{F_{\max}} \times 22$
4	Koha e zbatimit të punimeve (muaj)	Vlerën minimale të kriterit	19	$P_i = \frac{T_{\min}}{T_i} \times 18$
5	Skema e lidhjes së centralit me sistemin elektroenergjitik		17	
TOTALI I PIKEVE			100	

Ku:

- P_i - Piket e llogaritura të ofertuesit (i);
- Fee_i - Fee koncesionare e ofertuesit (i) (sasia e energjisë elektrike që i korrespondon % se shprehur);
- $Fee_{(\max)}$ - Fee koncesionare maksimale e ofruar (sasia e energjisë elektrike që i korrespondon % se shprehur);
- F_i - Fuqia e ofertuesit (i);
- F_{\max} - Fuqia maksimale e llogaritur për prurje mesatare shumëvjeçare;
- T_{\min} - Koha minimale e ofertuar;
- T_i - Koha e ofertuesit (i);

Kriteret e paraqitura në Oferte përbejnë kushte të panegociueshem të Kontratës Koncesionare dhe nuk mund të ndryshohen.

Shpjegime për kriteret e përzgjedhjes së fituesit dhe metodologjinë e vlerësimit gjatë procedurës konkurruese:

1. Vlera e “Fë koncesionare”.

Është taksa (royalty) që koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktues për përdorimin e burimit hidrik si pasuri kombëtare. Vlera e saj shprehet me sasinë e energjisë elektrike që koncesionari i jep çdo vit shtetit, në masën: **minimumi 2%**, vlerë e cila do të parashikohet në kontratë si një kusht i panegociueshem i saj. Mënyra e llogaritjes së pikëve do të jetë në bazë të sasisë së energjisë elektrike që koncesionari i jep çdo vit shtetit. – **20 pike**

Përveç sa me sipër autoriteti kontraktor përfiton në të njëjtën masë nga çdo përfitim tjetër që Koncesionari do të sigurojë si rezultat i prodhimit të kësaj energjie elektrike, duke përfshirë por pa u limituar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.

2. Ndikimi ekologjik dhe social i projektit

- i) Do të vlerësohet me piket maksimale paraqitja e një plani monitorimi të masave zbutëse në lidhje me ndikimin që vepra hidroenergjetike do të ketë në mjedis (florën, faunën, token, ujë, ajër) si dhe në mikroklimën e ambientit. - **12 pike**
- ii) Investime shtesë të parashikuara në ndihmë të infrastrukturës së zonës. - **10 pike**

***Shënim:** Informacioni dhe çështjet që duhet të trajtohen në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis përshkruhen Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. i ndryshuar. Megjithatë në raportin VNM mund të trajtohen edhe çështje të tjera të identifikuara gjatë plotësimit të saj.*

3. Fuqia e instaluar

Matet në KW dhe shpreh vlerën totale të fuqisë së instaluar të njëjës hidroenergjetike, të përcaktuar me prurjen llogaritëse të aksit të parashikuar. Makineritë dhe pajisjet që parashikohen të vendosen të garantojnë standartet teknike të praktikave të mira industriale të këtij sektori – **22 pike**

4. Koha e vënies në zbatim të punimeve është:

Afati, nga data kur Koncesionari është pajisur me të gjitha lejet e nevojshme për fillimin e punimeve deri në datën e vënies në punë eficientë të HEC-it/eve. Ky afat është kriter vlerësimi, sipas tabelës së mësipërme. - **19 pike**

Kujdes!

Koha e ofruar për zbatimin e punimeve, do të jetë pjesë e Kontratës së Koncesionit si kusht i panegociueshem i saj.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, (nese eshte e nevojshme do te kerkoje asistence nga konsulenti i jashtem), do te shqyrtoje grafikun e punimeve dhe afatin e paraqitur ne oferte dhe, ne rast se konstaton se afati i deklaruar nga ofertuesi eshte jashte çdo praktike te mire industriale

(sipas normave mesatare shqiptare dhe ndërkombëtare te realizimit te një vepre te tille energjetike), atëherë do te vendose qe ofertuesi per këtë kriter te mos marre asnje pike.

5. Skema e lidhjes se centralit me sistemin elektroenergjitik (duke analizuar jo me pak se dy variante si dhe argumentimi i variantit të propozuar).

Ky kriter vlerësohet me 17 pike si vijon: Skema elektrike do të vlerësohet nga siguria e punës se centralit Skema e lidhjes se centralit me sistemin elektroenergjitik do të vlerësohet nga pikëpamja tekniko-ekonomik e skemës se zgjedhur (niveli i humbjeve të tensionit të energjisë elektrike dhe vlera e investimit),